



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Pedagogjisë

Me datë: 19.09.2022

AIDA BAFTIJARI

Tema: Qëndrimet e mësimit në rreth formave të zhvillimit profesional të mësimit në rreth formave të arsimit fillor në rrethanat e reja të krijuara nga COVID-19

Komisioni: Prof. Ass. Jehona Ferizi Miftari
Prof. Asoc. Blerim Saqipi, kryetar
Prof. Asoc. Valbona Berisha, anëtare

Abstrakti

Rrethanat e reja të krijuara nga pandemia COVID-19 kanë bërë ndryshime në të gjitha sferat dhe veprimtaritë njerëzore, prandaj të gjithëve iu është dashur të përshtaten me këto ndryshime. Pandemia ka ndikuar edhe në sistemin tonë arsimor duke e ndryshuar modalitetin e mësimit nga ajo fizike në mësimit në distancë përmes shfrytëzimit të teknologjisë bashkëkohore. Ky ndryshim ka dërguar edhe në vështirësi për mësimit dhe për zhvillimin e tyre profesional të vazhdueshëm i cili ua ka pamundësuar ndjekjen e formave të zhvillimit profesional në mënyrë fizike. Prandaj qëllimi i këtij hulumtimi është të nxjerrë në pah këndvështrimet e mësimit lidhur me efektivitetin e formave të zhvillimit profesional të ndjekura në distancë. Në këtë hulumtim është përdorur metodologjia e hulumtimit sasior, ashtu që për mbledhjen e të dhënave sasimore është shfrytëzuar pyetësi. Në mostrën e përgjithshme të hulumtimit janë përfshirë gjithsej 100 mësimit, ku përmes pyetësit mësimit kanë ofruar informacionin për format e zhvillimit profesional që ata ndjekën në distancë, si dhe nëse ata e cilësuan efektive zhvillimin profesional të tyre në rrethanat të reja të krijuara nga COVID-19. Hulumtimi iu është përgjigjur këtyre pyetjeve kërkimore: Si ndikojnë format e zhvillimit profesional në distancë në zhvillimin e tyre profesional si mësimit?; Si ndikojnë format e zhvillimit profesional të ndjekura në distancë në përmirësimin e mësimit?; A ndikuan format e zhvillimit profesional të ndjekura në distancë në zhvillimin e shkathhtësive teknologjike të mësimit, dhe sipas të dhënave të

mblledhura nga respondentët erdhëm në përfundim që sipas qëndrimeve të mësimdhënësve, format e zhvillimit profesional të ndjekura në distancë patën efekt pozitiv në zhvillimin e tyre profesional, sepse sipas rezultateve kemi një korrelacion pozitiv në mes të dy variablave ku si variabël e pavarur janë format e zhvillimit profesional dhe variabla e varur është zhvillimi profesional i mësimdhënësve. Ky korrelacion tregon se format e zhvillimit profesional të ndjekura në distancë kanë lidhje sinjifikante pozitive në rritjen e suksesit të mësimdhënësve dhe arritjeve të tyre në përgjithësi, $p\text{-value} < 0.01$.

Fjalët kyçe: *arsim fillor, COVID-19, format e zhvillimit profesional, mësimi në distancë, zhvillimi profesional*

SHQIPDONA KRASNIQI

Tema: Përdorimi i TIK-ut në mësimdhënien e gjuhës shqipe në shkollat fillore të mesme të ulëta (kl I-IX)

1. Prof. asoc. dr. Kastriot Buza- kryetar
2. Prof. ass. Kyvete Shatri- anëtar
3. Prof. dr. Naser Pajaziti-mentor

ABSTRAKTI

Mësimi elektronik është një rrugë jo shumë e përdorur në shoqërinë tonë. Në vendet e zhvilluara, ndërkaq, ai është bërë njëra nga rrugët më të shfrytëzuara për arsimim, madje edhe për zhvillimin profesional dhe të nxëniet gjatë gjithë jetës. Nevoja dhe arsyeja e aplikimit të TIK-ut në arsim nisët nga fakti i përgatitjes së të rinjve për tu bërë liderë dhe të suksesshëm në këtë shoqëri të udhëhequr nga informacionet. Ky punim ka për qëllim që të trajtojë hollësisht zbatimin e teknologjisë (tik-ut) në mësimdhënien e gjuhës shqipe duke treguar se a e ndihmon procesin e mësimdhënies dhe në cilat zona rurale apo urbane përdorimi i tik-ut është më i madh. Popullata e këtij hulumtimi përfshinë të gjithë mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në Komunën e Drenasit. Është punim kuantitativ. Të dhënat statistikore për numrin e shkollave dhe numrin e mësimdhënësve janë nga burime zyrtare, përkatësisht nga (Masht" Statistika e Arsimit nw Kosovw", 2019-2020). Pra, popullata e këtij hulumtimi përbëhet nga 573 mësimdhënës, nga 30 shfmu gjithsej. Mostra është zgjedhur në mënyrë të rastësishme, është mostër sistematike. Dhjetë % (përqind) e mësimdhënësve është mostër e hulumtimit-57 mësimdhënës (pjesëmarrës). Njëzet % (përqind) e shkollave janë pjesëmarrëse në hulumtim, d.m.th, gjithsej 7 shkolla. Hulumtimi u realizua përmes një pyetësori i cili do të masë qëndrimet e mësimdhënësve në lidhje me zbatimin e teknologjisë në mësimdhënjen e gjuhës shqipe. Të dhënat do të realizohen përmes paketës statistikore SPSS. Studimi ynë mund të jetë i dobishëm për institucionet që e udhëheqin shkollën, për arsimtarët dhe nxënësit duke marrë hapa së bashku në krijimin e kushteve të favorshme për integrimin dhe përdorimin e teknologjisë mësimore, identifikimin e faktorëve që e pengojnë zbatimin e teknologjisë mësimore, vënia në pah e efekteve positive të zbatimit të teknologjisë mësimore në mësim si njëra nga kompetencat e rëndësishme që ofron mësimdhënja bashkëkohore.

Fjalët kyçe: Teknologjia informative, kompjuteri, shkolla, cilësia, mësimi.

